



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Tregu i Bizneseve

QËLLIMI

Tregu i Bizneseve ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla, bizneseve me ide kreative dhe OJQ-ve. Qëllimi i këtij tregu është krijimi i hapësirave dhe mundësive për bizneset dhe OJQ-të në kryeqytet, me theks të veçantë atyre që veprimtarinë kryesore e kanë punën e dorës.

Përfituesit e këtyre shtëpizave do të kenë rastin të bëjnë shitjen e veshjeve tradicionale, suvenireve, aksesoreve, dhuratave, kartolinave punëdore, luleve etj., në 6 shtëpiza në sheshin "Edit Durham".

RREGULLAT E TREGUT TË BIZNESEVE

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e Tregut të Bizneseve do të bëhet në muajin Qershor 2022 në sheshin "Edit Durham", ku do të qëndrojë i hapur deri në muajin Nëntor, me mundësi të vazhdimit të kontratave për përfituesit.

Gjatë këtyre muajve përfituesit lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 22:00. Asnjë shitje nuk do të lejohet para orës 09:00 si dhe pas orës 22:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e aplikuesve do të bëhet nga një komision i posaçëm i formuar nga Komuna e Prishtinës. Pasi numri i shtëpizave do të jetë i limituar është bërë aplikimi i kriterëve si më poshtë në mënyrë që selektimi të jetë sa më adekuat:

- Aplikimi do të bëhet për shitjen e veshjeve tradicionale, suvenireve, aksesoreve, dhuratave dhe kartolinave punëdore, luleve, etj.
- Aplikuesit duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe të jenë pajisur me arkë fiskale;



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

- Aplikuesit duhet të kenë dëshmi të ushtrimit të veprimtarisë specifike për të cilën do të aplikojnë;
- Aplikuesit duhet të jenë pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Tregun e Biznesve.
- Bizneset/OJQ –të të cilat udhëhiqen nga gratë, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset/ OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Komunën e Prishtinës, do të trajtohen me prioritet.
- Aplikuesit të cilat dorëzojnë dokumentacionin e aplikimit të parat që nga data e njoftimit, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset/OJQ-të të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet.
- Në rast të numrit të madh të të interesuarve, do të shqyrtohet mundësia e shfrytëzimit të shtëpizave me rotacion.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizave

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut të bizneseve janë përcaktuar duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, përfituesit do të jenë të obliguar të paguajnë paraprakisht shumën prej **10.00 Euro për m2** për periudhë një mujore të shfrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

Të gjithë shfrytëzuesit e shtëpizave janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfillt në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetë sa më mirë, Komuna e Prishtinës ndalon rreptësishtë aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda hapësirës të tregut;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë përfituesit konkurrues, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave;



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

- Obligohen të gjithë përfituesit që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth saj.

Nëse bëhet kryerjen e akteve të lartë shënuara, sanksionimi do të jetë marrja e lejes për shtëpizë, dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzim të saj.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohen prej 07 deri 15 Qershor 2022, në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, sporteli nr 1. në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër).